

VENDIM
"Ne Emer te Republikes"

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, e perbere nga:

Mirela MISHGJONI - GJYQTARE

Asistuar nga sekretare e seances gjyqesore Danaida Zanaj, ne Vlore me date 29.09.2014, ora 13.30, ne seance gjyqesore, shqyrtoi kerkesen penale nr.417 akti, qe i perket:

- KERKUESE:** Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, e perfaqesuar nga prokurore [REDACTED]
- OBJEKTI:** Caktim sekuestrimi prane [REDACTED] Bank te shumes ne llogarine bankare nr.AL42202260000000000001070515.
- BAZA LIGJORE:** Neni 210 i Kodit Procedures Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi ceshtjen, degjoi prokurorin qe kerkoj qe ne kuader te procedimit penal nr.1779/2014, te "Caktohet sekuestrimi prane [REDACTED], Filiali Vlore e shumes 80,000euro ne llogarine bankare nr.AL42202260000000000001070515, ne emer te shtetasit [REDACTED], pasi administroi dhe shqyrtoi aktet ne teresi:

VEREN

Me kerkesen objekt gjykimi, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore ka kerkuar sekuestrimin prane [REDACTED] Bank, Filiali Vlore, te shumes 80,000euro ne llogarine bankare nr.AL42202260000000000001070515, llogari qe rezulton ne emer te shtetasit [REDACTED], pasi dyshohet se eshte produkt i vepres penale te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga gjykimi rezultoi e vertetuar se mbi bazen e informacionit per referimin e vepres penale date 26.09.2014, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, ka filluar

procedimin penal nr.1779/2014, per veprën penale te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga të dhënat e këtij procedimi penal rezulton se në llogarinë e shtetasit [redacted] llogari në monedhen "euro", me nr. AL42202260000000000001070515, e hapur pranë bankës Raiffeisen Bank më datë 22.09.2014, është kredituar me anë të një transferte shuma prej 80.000 euro. Dërguesja e kësaj shume është shtetësjë [redacted] me banim në Monaco, por transferta është bërë nga llogaria e saj nr. LU370022192209219000 nga Luksemburgu.

Shtetasi [redacted] ka deklaruar se kjo dërgesë është bërë për llogari të kunatit të tij [redacted] për punë të kyera nga ai në pronën e [redacted] në shtetin grek. Sipas shtetasit [redacted] kunati i tij [redacted] ka autorizuar atë për të bërë pagesën e një kësti të lokalit [redacted] në vendin e quajtur [redacted] si dhe për të bërë pagesa të ndryshme. Rezulton se shtetasi [redacted] ka paraqitur ndonjë dokumentacion justifikues që të provojë origjinën e kësaj transferte.

Ne rrethana te tilla, bazuar ne dyshimet mbi paligjshmërinë e origjinës së kësaj transferte parash në emër të shtetasit [redacted] Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlore, me vendimin date 26.09.2014 ka vendosur "*Sekuestrimin e menjehershëm pranë Raiffaisen Bank, Filiali Vlore, te shumës 80,000euro te depozituar ne numrin e llogarise AL42202260000000000001070515, ne emer te shtetasit [redacted] i datelindjes 09.12.1972, lindur ne Vlore*".

Rezulton se vendimi date 26.09.2014 i Prokurorise se Rrethit Gjyqësor Vlore, eshte depozituar pranë Raiffeisen Bank po ne datën 26.06.2014 dhe ekzekutuar nga oficeret e policise gjyqësore te Prokurorise se rrethit gjyqësor Vlore, fakt qe provohet me shkresën nr.7480 prot, date 26.09.2014.

Pas kryerjes se ketyre veprimeve Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlore ka paraqitur kerkesen objekt gjykimi duke kerkuar sekuestrimin e te njejtës llogari bankare te sekuestruar prej saj me vendimin e dates 26.09.2014.

Gjykata cmon se kerkesa objekt gjykimi eshte e pabazuar ne ligj dhe nuk do te pranohet.

- Neni 208 i Kodit te Procedures Penale parashikon: "*1. Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. 2. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policise gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim. 3. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se është i pranishëm*".

- Neni 210 i Kodit te Procedures Penale parashikon: "*Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumentave, të letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjeje tjeter, edhe nese gjenden ne kasetat e sigurise, kur ka*

arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Ne raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori”.

- Neni 212 i Kodit të Procedurës Penale parashikon: “1. I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtën e kërkimit të tyre, mund të bëjnë ankim në gjykatë kundër vendimit të sekuestrimit. 2. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e vendimit.”.

Ne rastin objekt gjykimi, duke analizuar dispozitat e cituara me lart ne raport me rrethanat e ceshjes te provuara ne gjykim, gjykata cmon se kerkesa eshte e pabazuar ne ligj.

U provua se per shkak te ngutshmerise se rastit konkret, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, bazuar ne nenin 210 te Kodit te Procedurës Penale, me vendimin date 26.09.2014, ka vendosur “Sekuestrimin e menjehershem prane Raiffaisen Bank, Filiali Vlore, te shumes 80,000euro te depozituar ne numrin e llogarise AL422022600000000000001070515, ne emer te shtetasit [redacted] i datelindjes 09.12.1972, lindur ne Vlore”.

Sipas neneve 208 e 210 te Kodit te Procedurës Penale, nene qe rregullojne menyren e procedimit kur gjate hetimeve paraprake lind nevoja e sekuestrimit te provave materiale apo sendeve qe lidhen me vepren penale, perfshire edhe shumat e depozituara ne llogarite bankare, rezulton qe vendimi i sekuestrimit mund te merret nga gjykata ose nga prokurori, ne varesi te rrethanave konkrete te hetimit. Ne asnje nga dispozitat qe rregullojne kete institut te kerkimit te proves nuk parashikohet vlefesimi i vendimit te prokurorit nga gjykata apo rikonfirmimi i ketij vendimi gjyqesisht. Perkundrazi, nga dispozitat e Seksionit III te Kodit te Procedurës Civile rezulton se ne rastet kur vendimi i sekuestrimit te provave materiale apo sendeve qe lidhen me vepren penale, perfshire edhe shumat e depozituara ne llogarite bankare, eshte marre nga prokurori, kunder ketij vendimi lejohet ankim ne gjykate, pra ne asnje rast nuk parashikohet vlefesimi i vendimit te prokurorit nga gjykata apo dublimi i tij.

Perfundimisht, gjykata cmon se kerkesa e paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore eshte e pabazuar ne ligj, per rrjedhoje nuk do te pranohet.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 208, 210 te Kodit te Procedurës Penale,


VENDOSI

- Rrezimin e kerkeses penale nr.417, date 26.09.2014, qe i perket: Kerkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore. Objekti: “Caktim sekuestrimi prane bankes”.
- Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen kerkuesit.

- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 diteve nga e nesërmyja e shpalljes.

Vlorë më 29.09.2014

SEKRETARE
Danaida ZANAJ



GJYQTARE
Mirela MISHGJONI




Kancelare
Rezarta Taushani



Vendimi mori formë të prerë
pasi nuk u ankimua
më dt. 09. 10. 2014
Vlorë më dt. 10. 10. 2014

K/ sekretare



01/7